



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHIME

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 306 Prot. Datë 30.10 2017
12

Nr. 1450 Prot. Datë 30.10 2017

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 1181, Datë 30.10.2017

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E REGJISTRIT ELEKTRONIK TË SUBJEKTEVE QË MARRIN MASA SHITESË TË SIGURISË PUBLIKE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”, Ministri i Brendshëm dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

1. Ngritjen e regjistrit elektronik për evidentimin dhe administrimin e të dhënave të subjekteve që marrin masa shtesë të sigurisë publike, sipas modelit bashkëlidhur këtij udhëzimi, si pjesë përbërëse e tij.
2. Regjistri elektronik shërben si bazë të dhënash qendrore dhe vendore, për subjektet që marrin masa shtesë të sigurisë publike dhe administrohet nga Policia e Shtetit.
3. Ky regjistër përmban të dhënat e përcaktuara në pikën 1, të nenit 5, në nenet 6, 8, 9, 15 dhe 16, të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” dhe është vetëm për përdorim të brendshëm të strukturave të Policisë së Shtetit sipas parashikimeve të ligjit nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike”.

4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka akses me të drejtë leximi në regjistrin elektronik për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 19/2016 “Për masat shtesë të sigurisë publike” dhe në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
5. Mënyra e regjistrimit dhe administrimit të të dhënave të subjekteve që marrin masa shtesë të sigurisë publike, si dhe funksionimi i regjistrit elektronik përcaktohen sipas procedurave standarde të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
6. Ngarkohen strukturat përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

MINISTRI I BRENDSHËM

FATMIR XHAFAJ



**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE**

BESNIK DERVISHI



